

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave dhe Qendra për Ndarjen e Mbetjeve të Riciklueshme në Lezhë

Përmbledhje e projektit

Në vitin 2011, Bashkia Lezhë është shpallur fituese e një granti nga dldp për bashkëfinancimin e projektit “Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve dhe ndërtimi i qendrës për ndarje dhe riciklim”. Projekti arriti të harmonizojë përpjekjet dhe kombinojë financimin me një tjetër mbështetje: “Pastrimi me pjesëmarrje i plastikës dhe menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Lezhë” financuar nga Ambasada Hollandeze në Shqipëri, në kuadër të programit MATRA.

Rezultatet e projektit kontribuojnë në zbatimin e *Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve*.

Aktivitetet kryesore të projektit janë:

Plani për menaxhimin e mbetjeve të ngurta: bazuar në menaxhimin me bazë performance dhe i fokusuar tek rezultatet e shërbimit.

Ngritjen e Qendrës për Ndarje dhe Riciklim: destinacioni i qendrës është shërbimi për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme, të cilat do të grumbullohen të ndara në burim. Me ngritjen e saj Bashkia redukton sasinë e gërosur në landfill të mbetjeve inorganike të riciklueshme (fillimisht plastikë dhe letër), të cilat mund të përdoren për të nxitur dhe zhvilluar industrinë e riciklimit në vend.



Donator:

Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SCO-AI)

Kohëzgjatja e projektit:

Shkurt 2011 - Mars 2012

Kontributi zviceran (nëpërmjet dldp) dhe NJQV:

39 540 Euro dhe 9 800 Euro

Përfitues:

Bashkia Lezhë
Shoqata e Ricikluesve

Asistenca teknike:

URI (Instituti i Kërkimeve Urbane)

Rezultatet e projektit:

Hartimi i planit të menaxhimit të mbeturinave
Hartimi i studimit të fizibilitetit të qendrës për ndarje e riciklim (QNRM)
Rikonstrukcion dhe pajisje e qendrës me makineritë e nevojshme

OBJEKTIVAT E BASHKISË PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE:

1. Grumbullim i ndarë i mbetjeve në dy rryma për letër dhe plastikë

Viti I : Në Zonën A ose në 46% të familjeve mbetjet grumbullohen e mblidhen të ndara

Viti II: Në Zonën A+B ose në 81% të familjeve mbetjet grumbullohen e mblidhen të ndara

Viti III-V: Në Zonat A+B+C ose në 100% të familjeve, mbetjet grumbullohen e mblidhen të ndara

2. Përgatitja nga QNMR i mbetjeve për riciklim (letër dhe plastikë)

Viti I : 17% e peshës së mbetjeve përgatiten për riciklim nga QNMR

Viti II : 30% e peshës së mbetjeve përgatiten për riciklim nga QNMR

Viti III-V : 37% e peshës së mbetjeve përgatiten për riciklim nga QNMR

3. Reduktimi i mbetjeve që depozitohen në landfill

Viti parë : 83% e mbetjeve shkojnë në landfillin e Bushatit

Viti II : 70% e mbetjeve shkojnë në landfillin e Bushatit

Viti III-V: 63% e mbetjeve shkojnë në landfillin e Bushatit